

Procesi i privatizimit dhe vlera e asetëve të KEDS

Pikat kryesore në këtë dokument:

- Qeveria e Kosovës nuk është treguar transparente dhe e përgjegjshme në procesin e privatizimit të distribucionit dhe furnizimit të energjisë (KEDS);
- Duke u bazuar në njoftimet e nxjerra nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), Instituti GAP ka hartuar një listë të të gjitha investimeve në rrjetin e energjisë në periudhën 2007-2012, vlera e të cilave kap shifrën e 55 milion eurove;
- Po nga këto njoftime, GAP ka hartuar një listë të investimeve që 21 komuna të Kosovës kanë bërë në rrjetin e energjisë në periudhën 2009-2012, vlera e të cilave kap shifrën e afro 800.000 eurove;
- Sipas vetë zyrtarëve të KEK, nga viti 1999 e deri më 2011 në rrjetin e energjisë janë investuar 180 milion euro, por kjo shifër mund të jetë shumëfish më e madhe;
- Qeveria e Kosovës gjatë procesit të privatizimit ka shkelur parimet e vendosura nga Kuvendi i Kosovës më datë 12 dhjetor 2008, kur i është dhënë mbështetje në parim procesit të privatizimit të KEDS;
- Se procesi i privatizimit të KEDS nuk është udhëhequr në mënyrë të drejtë, dëshmon edhe procesi hetimor që është duke u zhvilluar ndaj këshilltarit të transaksionit nga Ombudspersoni i Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC);
- Nëse Ombudspersoni i IFC ka bazë për hetim ndaj punonjësit të saj i angazhuar në këtë proces, Kuvendi i Kosovës do të duhej të ndërpres procesin e privatizimit dhe të themeloj një komision hetimor për të hetuar procesin e gjertanishëm të privatizimit të KEDS.

Hyrje

Qeveria e Republikës së Kosovës është e vendosur që të shes Kompaninë e Distribucionit dhe Furnizimit me Energji Elektrike (KEDS), përkundër vlerës së ulët të ofertës që kanë ofruar kompanitë e parakualifikuara. Qeveria e Kosovës ka vendosur të shes KEDS-in për 26.3 milion euro.

Përkundër asaj se vendimi për privatizimin e KEDS është marrë saktësisht katër vite më parë (2 tetor 2008), asnjëherë përgjatë këtij procesi nuk është bërë e ditur vlera reale e asetëve dhe tregut të KEDS. Përkundër kërkesave të shumta zyrtare drejtuar ndaj Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Korporatës Energjetike të Kosovës dhe këshilltarëve të transaksionit të Korporatës Ndërkombëtare Financiare, për vlerën e asetëve të KEDS asnjëherë këto institucione nuk kanë pranuar të përgjigjen se cilat janë asetet e KEDS dhe sa është vlera e tyre.

Qeveria e Kosovës këto informata nuk ka pranuar ti ndaj as me deputetët e Kuvendit të Kosovës, edhe pse për këtë e obligon vendimi i Kuvendit i datës 12 dhjetor 2008. Më 3 tetor 2012, deputetët e Kuvendit të Kosovës do të diskutojnë lidhur me procesin e privatizimit të ndërmarrjeve publike, ndër to edhe për privatizimin e KEDS.

Në mungesë të informatave zyrtare nga MZHE dhe KEK, ky dokument hulumtues i Institutit për Studime të Avancuara GAP synon të ofroj një pasqyrë të vlerës reale të asetëve të KEDS dhe sidomos investimet e KEK të bëra në rrjetin e energjisë në periudhën 2007-2012.

Përmbledhje e shkurtër e procesit të privatizimit

Më 2 tetor 2008 Qeveria e Kosovës mori vendim për privatizimin e distribuimit dhe furnizimit të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK).¹ Gjashtë ditë më vonë qeveria mori vendim për formimin e grupit punues ndërqeveritar i cili do të barte procesin e privatizimit.²

¹ Vendimi i qeverisë Nr.03/38 për privatizimin e KEDS, 02.10.2008

² Vendimi i qeverisë Nr.08/39 për privatizimin e KEDS, 08.10.2008

Ndërsa më 12 dhjetor të të njëjtit vit, ky vendim i qeverisë mori edhe mbështetjen në parim nga Kuvendi i Kosovës.

Projekti i privatizimit të distribucionit dhe furnizimit menaxhohet nga Njësia për Zbatimin e Projektit (PIU), e cila raporton direkt tek grupi punues për privatizim. PIU është njësi teknike e projektit të privatizimit e cila është e ngarkuar për ekzekutimin, menaxhimin, dhe mbikëqyrjen e zhvillimit të projektit. Për aspektin energjetik kjo njësi këshillohet më tutje nga Deloitte, kompani e kontraktuar nga USAID, dhe për aspektin e transaksionit nga Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC), anëtare e Bankës Botërore.

Pas përfundimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve për para-kualifikim, me datën 6 prill 2011 shpallen katër kompanitë të cilat kishin aplikuar. Këto ishin Calik Holding dhe Limak Holding të regjistruara në Turqi, Elsewedy Electric e regjistruar në Egjipt, dhe Konkorsiumi TAIB – Yildizlar e regjistruar në Turqi dhe Bahrejn. Të katër kompanitë e kaluan fazën e para-kualifikimit. Ndërsa pas një afati prej 8 muajsh, gjatë të cilës kompanitë kishin qasje në Dhomën e të Dhënave dhe po përgatitnin ofertat, kompanitë kërkuan nga komiteti për privatizim t'i lejoje të krijojnë konkorsiume. Kështu u formuan konkorsiumet Limak-Calik dhe Elsewedy.

Me datën 9 qershor 2012 konkorsiumi Limak-Calik shpallet fitues për privatizimin e KEDS pasi kishte ofruar shumën më të madhe, 26.3 milion euro. Kjo ofertë ishte 3.5 milion euro më e madhe sesa oferta e konkorsiumit Elsewedy. Me të shpallur fituesin për privatizim të KEDS fillon faza e fundit e këtij procesi: negociatat e fundit në mes të fituesit dhe Qeverisë së Kosovës, e cila në fund vendos për shpalljen përfundimtare të fituesit apo të kthej procesin serish nga e para.

Divizioni i shpërndarjes së rrymës është i organizuar në shtatë distrikte që mbulon tërë territorin e Kosovës, ndërsa distriktet janë të organizuara në bazë regjionale. Divizion i Shpërndarjes është përgjegjës për mirëmbajtjen e stabilimenteve elektro-energjetike nga niveli 110 kV (nga transformatori) e deri tek konsumatori i fundit. Gjithashtu bën planifikimin, zhvillimin, operimin, matjen, leximin dhe llogaritjen e energjisë dhe të humbjeve teknike për të gjithë infrastrukturën e rrjetit të KEK-ut.³

³ Burimi: <http://www.kek-energy.com/rrjeti.asp>

Divizioni i shpërndarjes ka në pronësi 675 km të rrjetit 35 kV. Rrjeti 10(20) kV është në gjatësi prej rreth 445 km, 10 kV në gjatësi prej rreth 5863 km, 6 kV në gjatësi prej rreth 46 km dhe rrjeti 0.4 kV është në gjatësi prej rreth 11.870 km. Ky Divizion ka në pronësi të vet 6.200 trafo stacione të nivelit nga 220 kV (nga transformatori) deri në 10(20)/0.4 kV. Ndërsa mbetet e paqartë nëse objektet e KEK-ut dhe cilat objekte mbeten në pronësi të divizionit të shpërndarjes dhe furnizimit.⁴

Mos respektimi i vendimit të Kuvendit të Kosovës për shitjen e KEDS

Më 12 dhjetor 2008, pas rekomandimeve të dhëna nga Komisioni Parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion, Kuvendi i Kosovës i dha mbështetje në parim nismës së Qeverisë për të privatizuar KEDS-in. Rekomandimet e komisionit të aprovuara në seancë plenare ishin:

- Duhet të realizohet dhe të përfundohet transformimi i plotë organizativ i korporatizimit të KEK-ut duke e përcaktuar statusin formal juridik të secilës njësi në kuadër të ndërmarrjes publike të KEK-ut;
- Gjatë vitit 2009 të përcillet dhe të merren parasysh rezultatet e afarizmit ekonomik për secilën njësi veç e veç;
- Të merret parasysh ndikimi i krizës globale në çmimin ofertues në procesin e privatizimit;
- Procedurat e privatizimit të fillojnë varësisht nga rezultati i fizibilitetit dhe konkluzioneve analitike në aspektin e afarizmit ekonomik, me kusht që privatizimi i njësisë së caktuar të jetë prioritet dhe përparësi ekonomike për vendin.

Qeveria e Kosovës nuk i është përmbajt të gjitha parimeve të vendosura nga Kuvendi i Kosovës. Edhe pse është krijuar ndërmarrja e re e KEDS me Ligjin për ndërmarrjet publike⁵, transformimi i plotë i kësaj ndërmarrje ende nuk ka ndodhur. Publiku i gjerë dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk janë të informuar se pas shthurjes së KEDS nga KEK, cilat asete do të privatizohen? Shkelje tjetër e parimit të vendosur nga Kuvendi i Kosovës është edhe mos

⁴ Marrë nga Raporti Vjetor 2011 i Zyrës së Rregullatorit për Energji. Burimi: http://ero-ks.org/Annual%20Report/Annual%20Report%202011/Raporti_Vjetor_2011.pdf

⁵ Ligji nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike.

marrja parasysh e ndikimit që do të ketë kriza financiare globale. Qeveria e Kosovës, në kohë të krizës financiare, ka vendosur të shesë ndërmarrjen publike KEDS, duke pranuar çmimin prej 26.3 milion eurosh.

Jo transparenca e Qeverisë së Kosovës në procesin e privatizimit të KEDS

I tërë procesi i privatizimit të KEDS ka qenë jo transparent. Përkundër kërkesave të shumta drejtuar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, KEK-ut, Njësisë Impmenetuese për Privatizimin e KEDS, këshilltarit të transaksionit nga Korporata Ndërkombëtare Finaciare, asnjë nga këto institucione nuk janë përgjigjur kërkesave për hapje të procesit të privatizimit. Shkelje tjetër paraqet edhe mos informimi i punëtorëve me procesin e privatizimit dhe ndikimi që ky proces do të ketë në punën e tyre.

Për shkak të dyshimeve në shkeljen e procedurave me rastin e privatizimit të KEDS, Ombudspersoni i IFC është duke e inspektuar procesin e gjertanishëm të privatizimit të KEDS. Ekziston dyshimi i bazuar se këshilltari i transaksionit të IFC, nuk është kujdesur që klienti i tij (Qeveria e Kosovës) të respektoj procedurat dhe parimet demokratike me rastin e privatizimit të KEDS. Ombudspersoni i IFC pritet të dal me një vendim në muajt në vazhdim dhe kjo paraqet arsye shtesë se përse procesi i privatizimit të KEDS duhet të ndërpritet.

Niveli i investimeve në KEDS dhe vlera e privatizimit

Në pesë vitet e fundit (2007 - 2012) në rrjetin shpërndarës të rrymës janë investuar mbi 55 milionë euro nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK). Kjo shifër është e përafërt, ngase shumë shpenzime të tjera në mirëmbajtjen, forcimin dhe zgjerimin e këtij rrjeti nuk janë përfshirë në shifrën e 55 milionë eurove. Vlerësimet në shpenzimet e bëra në rrjetin shpërndarës të energjisë janë fokusuar kryesisht në blerjen e pajisjeve për rrjetin si blerja e kabllave energjetike, furnizim më shtylla betoni dhe shtylla të drurit, furnizim më pajisje të rrjetit energjetik, forcimi i transformatorëve, blerja e trafo stacioneve,

furnizim më transformator matës të rrymës, furnizim më siguresa për trafo e kështu më radhë. Detajet mbi këto investime mund të shihen ne Shtojcën I.

Vlerësimi i shpenzimeve në pesë vitet e fundit lë pa llogaritur edhe shpenzimet e tjera të bëra nga KEK për shtatë vite tjera (1999 -2006), periudhë kjo që llogaritet më shkallën me të madhe të investimeve në këtë korporatë të ardhura kryesisht nga donacionet ndërkombëtare dhe ato nga Qeveria e Kosovës. Mirëpo, sipas vetë deklaratave të zyrtarëve të KEK, në periudhën 1999 - 2011 në rrjet janë investuar 180 milion euro.⁶

Investime në rrjetin shpërndarës të rrymës nuk ka bërë vetëm KEK-u, ndonëse ligjërisht vetëm kjo ka qenë e thirrur për diçka të tillë. Janë 21 komuna që gjithashtu kanë investuar shuma të konsiderueshme parash në mirëmbajtjen, forcimin dhe zgjerimin e rrjetit shpërndarës të rrymës. Te rasti i komunave, vlerësimi është bërë vetëm në tri vitet e fundit (2009-2012) duke rezultuar së komunat kanë shpenzuar afro 800.000 euro në rrjetin shpërndarës të rrymës. Karakteristike e cila vihet në pah në këtë mes është fakt se kjo ndodh me shumë në komunat e vogla dhe jo në komunat e mëdha. Komuna e Prishtinës, ajo e Pejës dhe e Mitrovicës nuk kanë shpenzuar asnjëherë mjete për rrjetin elektrikë apo zhvendosjen e shtyllave elektrike, kjo punë në këto komuna në të gjitha rastet është mbuluar nga KEK-u si teknikisht, proceduralisht po ashtu edhe financiarisht. Detajet mbi këto investime mund të shihen ne Shtojcën II.

Shumica e këtyre investime janë bërë pas vendimit të qeverisë të privatizojë divizionin e distribucionit dhe furnizimit të KEK-ut. Mbi të gjitha janë hasur edhe raste kur komunat kanë investuar mjete në rrjet elektrik edhe në fund të vitit 2011 dhe madje edhe në muajin e shtatë të vitit 2012.

⁶ Deklaratë e Drejtorit të Divizionit dhe Shpërndarjes në KEK z.Avni Alidemaj dhënë në debatin Jeta ne Kosove – Privatizimi i distribucionit të KEK-ut. Burimi: <http://gazetajnk.com/?cid=1,1029,33>

Përfundim

Shitja e distribucionit shpërndarës të rrymës në vlerën prej 26.3 milionë eurove, rezulton të jetë bërë pa ndonjë analizë të mirëfilltë të vlerës së ndërmarrjes, ngase sasia e parave të shpenzuara vetëm në pesë vitet e fundit në mirëmbajtjen, forcimin dhe zgjerimin e këtij rrjeti del të jetë trefish me e lartë së shuma e përgjithshme e shitjes. Nuk ka asnjë logjikë ekonomike që shitja e një biznesi të jetë në shumën më të ulët sesa investimi paraprak në të.

Qeveria e Kosovës nuk ka respektuar parimet e vendosura nga Kuvendi i Kosovës me rastin e aprovimit në parim të procesit të privatizimit të KEDS. Një nga parimet e vendosura nga Kuvendi i Kosovës ka qenë edhe marrja parasysh e krizës financiare globale, krizë e cila ka ndikuar në çmimin e ulët të shitjes së KEDS.

Përkundër kërkesave të shumta drejtuar Qeverisë së Kosovës për të bërë publike asetet e KEDS, nuk ka pranuar që një informatë të tillë ta ndaj me publikun e gjerë por as me deputetët e Kuvendit të Kosovës. Kjo sjellje e Qeverisë së Kosovës është në kundërshtim me parimet e transparencës të vendosura në Kushtetutën e Kosovës dhe në ligje të veçanta.

Rrjeti i Distribucionit dhe Furnizimit me Energji është shitur ende pa u bërë vlerësimet e duhura për gjendjen në rrjetin e energjisë dhe pa ekzistuar një plan për investime në vitet në vazhdim. Sipas Qeverisë së Kosovës, vetëm pas nënshkrimit të kontratës me konsorciumin fitues, tek atëherë do të bëhen vlerësimet për planin e investimeve në rrjet. Vlerësime të cilat nuk pritet të përfundojnë para fundit të vitit 2013.

Duke marrë parasysh sjelljet në këtë proces të Qeverisë së Kosovës, Kuvendi i Kosovës duhet të ndërpres privatizimin e KEDS dhe të krijoj një komision të posaçëm hetimor (ashtu siç është hapur rast hetimor nga Ombudspersoni i IFC), për të vlerësuar procesin e gjertanishëm të privatizimit të KEDS.

Shtojca 1: Investimet e KEK në rrjetin e energjisë 2007-2012

Shpenzimet në rrjetin energjetik nga KEK-u	
2012	
Kategoria	Shuma në Euro
Blerja e kablove energjetike	53.888,00
Furnizim më shtylla betoni	134.361,00
Furnizim më pajisje të rrjetit energjetik	44.960,00
Furnizim me ndarës të tensionit	176.572,00
Furnizim më shtëpiza për trafostacione deri në 150 kv	217.987,00
Furnizim më kablo energjetike	462.700,00
Ndërtimi i mureve mbrojtëse të transformatorëve	5.451,00
Furnizim më kablo energjetike	71.688,00
Furnizim më transformator matës të rrymës	47.022,00
Furnizim më siguresa për trafo	14.883,00
Furnizim për transformator në nën distrikte energjetike	396.578,00
Furnizim më material për ndërtimin e shtyllave elektrike dhe konzollave	67.057,00
Furnizim më kablo elektrike	454.366,00
Totali i shpenzimeve në 2012	2.147.505,00
2011	
Riparimi i transformatorit distributiv	24.842,00
Furnizim me kabull	9.952,00
Furnizim me kabull energjetike	258.340,00
Furnizim me material për ndërtimin e shtyllave të betonit	6.862,00
Furnizim me kabull përçues	3.700,00
Furnizim me shtrëngues të kablove	49.961,00
Furnizim me transformator	1.649.601,28
Furnizim me shkurtesa të tensionit	24.988,00
Riparimi i transformatorëve	122.534,00
Hartimi, ndërtimi dhe funksionalizimi i trafostacionit "Prishtina 7"	4.857.683,70
Furnizim me material harxhues elektrik	9.792,00
Zgjerimi i trafo stacioneve 110	772.618,00
Transformimi i trafo stacioneve në Deçan dhe Lipjan	33.450,00
Furnizim me pjesë rezervë për trafo stacione	379.732,00
Ormanë për trafo shtylla	79.660,00
Punë ndërtimore në trafo stacionin në Ferizaj	72.697,00
Furnizim më kablo energjetike	520.514,00
Mekanizim për prerjen e barit nëpër trafo stacione	79.765,00

Furnizim me transformator 40 MVA	749.601,00
Furnizim me transformator distributiv	451.055,00
Furnizim me ndërprerës të tensionit	47.985,00
Furnizim me material për shtylla dhe konzolla	64.724,00
Material për mbrojtjen e trafo stacioneve	98.310,00
Furnizim me kabullo elektrike	39.463,00
Mekanizim për hapjen e vrimave për vendosjen e shtyllave	65.598,00
Furnizim me material elektrik dhe kabull	6.470,00
Dislokimi i transformatorëve	49.300,00
Kutia degëzuese për shtyllat e tensionit të lartë	7.980,00
Valvula elektrike për shtyllat e tensionit	5.939,00
Furnizim me kabull elektrike në formë të bistakut	203.200,00
Totali i shpenzimeve në 2011	10.666.656,00
2010	
Furnizim me material për trafo stacione	18.553,00
Furnizim me transformator 40MVA -	1.049.600,00
Blerja e burgive për hapjen e vrimave për vendosjen e shtyllave elektrike	37.459,00
Furnizim me kabull të tensionit	31.916,00
Punë ndërtimore dhe elektrike nëpër trafo stacione	125.313,00
Transportimi i trafo stacionit 110/10 në relacionin Pejë - Lipjan	6.480,00
Furnizim me kabull energjetike	127.495,00
Rekonstruimi i 110/35kv në nënstacionin Palaj	6.954.582,67
Zgjerimi dhe forcimi i rrjetit distributiv	4.349.611,80
Termoizolimi i kabinave me penela shtresore	34.910,00
Furnizim me dhembzot dhe siguresa për trafo	9.696,00
Furnizim me shkarkues të tensionit	30.948,00
Furnizim me material elektrik për kompletimin e nënstacioneve	77.025,00
Furnizim me material elektrik për mirëmbajtjen e rrjetit	7.707,00
Pajisje për kthinën e transformatorit 110/10kv në zonën 'Prishtina2'	42.808,00
Material për prodhimin e shtyllave dhe konzollave	63.302,00
Transformator matës të rrymës dhe tensionit	56.619,00
Furnizim me pjese rezervë të transformatorëve 110/35kv	295.104,00
Riparimi i transformatorit	32.480,00
Furnizim me shtylla druri	285.244,00
Furnizim me shtylla betoni	237.891,00
Furnizim me kabull energjetike	232.779,00

Furnizim me pajisje për detektimin e humbjeve/vjedhjes së energjisë	105.800,00
Furnizim me beton për divizionet e shpërndarjes së rrymës	53.620,00
Furnizim me siguresa	7.806,00
Furnizim me siguresa të tensionit të lartë	9.985,00
Zgjerimi i trafo stacionit 35/10kv në Fushë Kosovë	5.916,00
Totali i shpenzimeve në 2010	14.290.629,00
2009	
Furnizim me material për shtylla	56.253,71
Furnizim me Kabull UTP	2.746,00
Forcimi dhe zgjerimi i rrjetit distributiv të KEK-ut	573.903,16
Furnizim me Siguresa VVC TL 12 KV për DRR	9.318,44
Furnizim me: "Konvertues të tensionit 24-12 V	4.974,60
Riparimi i transformatorëve distributive 10(20) /0.4 kV të fuqisë (630-1500) KVA dhe Riparimi i transformatorëve distributive 35 /10 kV të fuqisë (2500-8000) KVA	29.411,00
Ndërtimi dhe riparimi i rrjetit të tensionit të lartë dhe tensionit të ulët në 26 fshatra të Mitrovicës	1.491.611,43
Furnizim me Transformator distributiv Un=10(20)/0.4 kV dhe Un=35/0.4 kV	148.400,00
Furnizim me Siguresa TL 7.2 KV 20 A	2.983,00
Furnizim me material për prodhimin e konzollave dhe profileve të ndryshëm	8.289,36
Furnizim me material për prodhimin e konzollave	8.910,88
Furnizim me material ndërtimor dhe montimi në TS "Prishtina 3"	5.388,00
Furnizim me kushineta cilindrike 23064	7.424,00
Furnizimi me material izolues për elektromotor dhe transformator	60.824,12
Furnizim me Kabllo energjetik	243.990,00
Furnizim me kabull energjetik për nevoja të DPQ-së	456.460,50
Furnizim me njësores tre-fazor, gjysmë indirekt për konsumatorët komercial	499.500,00
Furnizim me pajisje për mbrojtje ne trafo stacion	9.833,32
Riparimi i transformatorëve distributive 10(20) kV të fuqisë (50 400) KVA	2.534,00
Furnizim me Siguresa të gjata dhe të shkurta TL 7.2 KV	8.027,20
Huazimi i lokalit me qira për Divizionin e Shpërndarjes-Drenas	4.800,00
Kabull nëntokësor për tension të mesëm dhe të lartë	17.550,00
Furnizim me mbrojtje të motorëve të trafo stacioneve	52.200,00
Furnizim me njësores tre-fazor, gjysmë indirekt për konsumatorët komercial	491.500,00

Dislokimi i trafo stacionit blinde TS 'Hasan Prishtina'	1.821,00
Matjet dhe shqyrtimet elektrike të transformatorëve	9.600,00
Furnizim me transformator energjetik 63 MVA	886.000,00
Furnizim me lidhëse kabllovike	9.955,00
Orman për trafo - shtylla	198.000,00
Servisimi i rregullatorit të transformatorit energjetik	291.283,98
Furnizim me Transformator distributiv	655.329,96
Furnizim me Instrument për testim të transformatorëve matës të rrymës	18.884,00
Furnizim me Transformatorë matës rrymor për montim të jashtëm	2.085,68
Furnizim me Elektromotor Asinkron Trofazor	64.341,00
Furnizim me pjese rezerve për njehsorë elektrik	47.034,22
Furnizim me Kabull 1 kv	6.159,60
Furnizim me Kabullo dhe ndërpresa	84.870,00
Furnizim me njësores tre-fazor, gjysmë indirekt për konsumatorët komercial	441.600,00
Furnizim me Pajisje për TS dhe pjesë të ndryshme rezervë	232.239,02
Njësor direkt për konsumator komercial	445.756,20
Furnizim me siguresa dhe bimetale	7.468,77
Furnizim me transformator energjetik 63 MVA	944.139,13
Furnizim me elemente lidhëse	70.574,40
Furnizim me kabullo	174.285,00
Transformator energjetik të thata	17.734,91
Totali i shpenzimeve në 2009	8.805.995,21
2008	
Transformator matës të rrymës	9.813,00
Furnizim me kabull energjetike	373.750,00
Mjete për trafo stacionin "Prishtina 1"	57.612,95
Siguresa për trafo stacione	6.650,00
Furnizim me kabull përçues	6.732,00
Ndërtimi dhe riparimi i rrjetit të tensionit të lartë dhe tensionit të ulët në 26 fshatra të Mitrovicës	1.751.804,20
Furnizim me orman për shtylla	432.500,00
Zgjerimi dhe forcimi i rrjetit distributiv ne distriktet e Prishtinës, Pejës, Prizrenit, Ferizajt, Gjakovës, Mitrovicës dhe Gjilanit	5.803.319,26
Furnizim me shtëpiza metalike për kabullo të tensionit të lartë	5.470,00
Blerja e baterive stacionare	7.792,00
Furnizim me elektro motor	41.949,00
Furnizim me konzolla	14.875,25
Furnizim me shtylla betoni	721.435,50
Mekanizim për testimin e njësoresve	172.646,29

Furnizim me ndërprerës 0.4kv	562.127,07
Furnizim me lidhëse kabllore	18.998,00
Furnizim me transformator matës të rrymës	136.203,48
Furnizim me kabull ajrore	36.340,00
Transformator energjetik distributiv	515.568,01
Furnizim me kthina për trafo stacionin "Prishtina 1"	1.743.321,00
Shtëpiza metalike për rrjetin e tensionit të ulet dhe të mesëm	282.800,00
Furnizim me Kabull energjetike	519.742,50
Furnizim me unaza shtrënguese elastike	53.912,00
Furnizim me shtylla druri	499.100,00
Furnizim me ndërprerës	23.669,30
Aksesor për kablllo	15.897,34
Riparimi i transformatorit 20MVA -110/10(20) kv	221.532,90
Totali i shpenzimeve në 2008	14.035.411,50
2007	
Blerja kabull gome dhe siguresa	30.630,00
Furnizim me kabull energjetike	106.832,00
Furnizim me shtylla betoni dhe konzolla	174.708,00
Furnizim me lidhëse dhe koka kabllore	174.242,00
Zgjerimi dhe përforcimi i rrjetit distributiv te KEK	3.235.136,66
Furnizim me transformator matës të rrymës 0.4kv dhe 10 kv	12.592,50
Furnizim me elemente lidhëse	363.852,41
Furnizim me shkurtesa të tensionit	89.815,00
Riparimi i transformatorëve	25.534,00
Furnizim me transformator matës të rrymës 35 kv dhe 10 kv	50.966,00
Furnizim me shtylla druri	92.172,50
Furnizim me transformator energjetik	536.207,00
Furnizim me transformator matës të rrymës	104.825,00
Totali i shpenzimeve në 2007	4.997.509,07
Totali i shpenzimeve 2007-2012	54.943.705,78

Shtojca 2: Investimet e komunave të Kosovës në rrjetin e energjisë 2009-2012

Komunat	Numri i investimeve në rrjetë	Vitet	Shuma
Deçan	4	2009-2012	18.217,00
<ul style="list-style-type: none"> • Furnizimi me material për trafo elektrike në fshatin Dubovik. Vlera 3.000 euro - 2012. • Furnizim me material për trafo elektrike në Gramaqel. Vlera 3.000 euro - 2010. • Furnizim me material elektrik për rrjetin e tensionit të ulët në Isniq. 2.230 euro. Furnizuesi - 2009. • Furnizim me material për rregullimin rrjetin elektrik të tensionit ulët në Rastovicë-Prejlep. Vlera 9.987 euro. 2009. 			
Ferizaj	1	2010	32.762,80
<ul style="list-style-type: none"> • Zhvendosja e trafos të tensionit të lartë. Vlera: 32.762.80 euro - 2010. 			
Gjakovë	2	2011	32.122,00
<ul style="list-style-type: none"> • Furnizimi dhe montimi me trafo stacionit në fshatrat Hereq, Palabardhë dhe Novoselë e Ulët. Vlera 9.870 - 2011 • Furnizim me material për trafo elektrike. Vlera 22.252.08 euro - 2011 			
Gjilan	3	2010-2011	70.175,00
<ul style="list-style-type: none"> • Rrjeti elektrik TU 0.4 KV zona qarku. Vlera 23.582.80 euro - 2010 • Trafostacioni Malishevë e Ulët - Gjilan. Vlera 14.919 euro - 2010 • Punimi i rrjetit elektrik tensioni i ulët në fshatin Sllubicë deri të xhamia. Vlera e investuar 31.674 euro - 2009 			
Hani i Elezit	1	2008-2010	49.889,40
<ul style="list-style-type: none"> • Zgjerimi i rrjetit elektrik. Vlera 49.839,40 euro (2008 -2010). 			
Istog	4	2009-2011	75.588,00
<ul style="list-style-type: none"> • Riparimi i rrjetit elektrik në fshatin Muzhevina - vlera 14.364 euro. Viti 2011 • Ndërtimi i trofove në Dobrushë, Llukavc, Kaliqan, lagja Shkoza" - vlera 24.647.50 euro - 2011 • Ndërtimi i trafos në lagjen Bardheci dhe Gecaj në fshatin Muzhevina. Vlera 21.522. viti 2010. • Ndërtimi i trafos elektrike në Banjë. Vlera 15.055,03 euro - 2009 			
Fushë Kosovë	2	2011	33.000,00
<ul style="list-style-type: none"> • Komuna e Fushë Kosovës në vitin e fundit (2011) ka shpenzuar mbi 33.000 euro për zgjerimin e rrjetit elektrikë. 			
Kaçanik	1	2010	37.741,00
<ul style="list-style-type: none"> • Punimi i rrjetit nëntokësor të tensionit të lartë në rrugën Ismail Raka. Vlera 37.741 euro. 2010. 			
Kamenicë	6	2010-2011	50.336,00

<ul style="list-style-type: none"> • Furnizimi dhe kablllo të rrymës 20 kv. Vlera 5.790 euro - 2011. • Përforcimi i rrymës elektrike. Vlera 16.863 euro. Viti 2011. • Montimi i trafostacionit 150 kVA në fshatin Krilevë. Vlera 3.592 euro. Viti 2011. • Rekonstruimi i rrjetit të tensionit të ultë në Kollolec. Vlera 1.722. Viti 2011. • Rekonstruimi i rrjetit të tensionit të ultë në Kollolec. Vlera 17.403,25 euro. Viti 2011. • Rekonstruimi i rrjetit 0.4 Kë në Topanicë. Vlera 4.966 euro. Vitit 2010. 			
Klinë	10	2009-2012	101.169,00
<ul style="list-style-type: none"> • Blerja e shtyllave elektrike dhe trafove. Vlera 12.288 euro. Viti 2009. • Rregullimi i sistemit për furnizim me rrymë për shkollat ne Sferke dhe ne Gjurgjevik. Vlera 2.743 euro. Viti 2012. • Furnizim me trafo në Radullovc. 9.970 euro. Viti 2011. • Dislokimi i rrjetit elektrik. Vlera 6.907. Viti 2011. • Furnizim me kablllo elektrik nëntokësor. Vlera 6.448 euro. Viti 2011. • Rregullimi i rrjetit elektrik në Qendrën për Pune Sociale. Vlera 3.241 euro. Viti 2011. • Dislokimi i rrjetit elektrik 9.950 euro. Viti 2010. • Rehabilitimi i rrjetit elektrik në fshatin Dollc. Vlera 3.953 euro. Viti 2010. • Zgjerimi i rrjetit elektrik në Gjurgjevik të Vogël. Vlera 33.327 euro. Viti 2009. • Rehabilitimi i rrjetit elektrik në Klinavc dhe Krushevë e madhe. Vlera 12.868 euro. 			
Malishevë	3	2011-2012	22.339,00
<ul style="list-style-type: none"> • Furnizim me trafo elektrike. Vlera 9.992 euro. Viti 2012. • Furnizimi dhe montimi i trafostacionit në fshatin Bardh. Vlera 9.850 euro. Viti 2011. • Vendosja e shtyllave elektrike në fshatin Carralluk. Vlera 2.497 euro. Viti 2011. 			
Mamushë	1	2011	22.000,00
<ul style="list-style-type: none"> • Furnizimi me transformator (trafo) të rrymës dhe pajisje përcjellëse. Vlera 22.000 euro. (2011). 			
Novobërdë	2	2011-2012	19.754,00
<ul style="list-style-type: none"> • Ndërtimi i rrjetit elektrik në lagjen Mehmetaj. Vlera 9.950 euro. Viti 2011. • Ndërtimi i rrjetit elektrik në lagjen e re, Makresh i Epërm. Viti 2012. Vlera 9.804 euro. 			
Prizren	1	2011	32.000,00
<ul style="list-style-type: none"> • Furnizim me kapriate për TS 10/20 /04 KË 160-250 KVA ne Prizren. Vlera 32.000 euro. (2011). 			
Rahovec	3	2010-2011	125.214,00
<ul style="list-style-type: none"> • Rregullimi i trafove të rrymës dhe rrjetit elektrik në Komunën e Rahovecit. Vlera 75.940 euro. Viti 2011. • Dislokimi i transformatorit elektrik. Vlera 4.374 euro. Viti 2010. • Rregullimi i rrjetit elektrik në zonën e QKMF-së në Rahovec. Vlera 44.900 euro. 			
Ranillug	1	2012	17.836,00
<ul style="list-style-type: none"> • Rregullimi i rrjetit elektrik për objektin e komunës. Vlera 17.836 euro. Viti 			

2012.			
Shtime	2	2009-2011	35.346,00
<ul style="list-style-type: none"> • Ndërrimi i rrjetit elektrik dhe trafo së rrymës për palestrën sportive. Vlera 27.716 euro. (2010). • Trafo për zonën e Kryqit të belincit. Vlera 7.630 euro. (2009) 			
Skenderaj	1	2011	9.600,00
<ul style="list-style-type: none"> • Furnizimi me një trafo elektrike për shkollën profesionale në Skenderaj. Vlera 9.600 euro. (2011) 			
Suharekë	3	2011-2012	21.791,00
<ul style="list-style-type: none"> • Ndërtimi i trafostacionit dhe rrjetit të rrymës në lagjen Pajtina në Gelacë. Vlera 14.775 euro. (2012). • Ndërtimi i trafo në lagjen Llugagjia 2 në fshatin Vraniq. Vlera 5.196 euro. (2012) • Blerja dhe montimi i materialit elektrik për trafo shkollën fillore “Destan Bajraktari”. Vlera 1.840 euro (2011). 			
Viti	3	2009	49.174,00
<ul style="list-style-type: none"> • Furnizim me material elektrik për rrugët e Vitisë. Vlera 14.078 euro. • Furnizim me trafostacion. Vlera 22.951 euro. • Lidhja e objektit komunal ne rrjetin elektrik. Vlera 12.145 euro. 			
Gjithsejtë			745.523,00

Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.